

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "ADER Travel & Tours" Sh.p.k.**

Sot, më datë 07 / 06/2022,

- **Zj. Erselana Shahinaj**, shtetase shqiptar, lindur më 05/08/1999, në Durrës, banuese në Durrës, mbajtëse e dokumentit Kartë Identiteti me nr. 033306414 dhe nr. Personal J95805009L, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "ADER Travel & Tours" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "ADER Travel & Tours" Sh.p.k.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Prof. Halil Myrto", Lagjia 12, Shk. 01, K.4, Ap.13, Zona Kadastrale 8513, Durrës.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**  
**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**  
**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Transport udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.



## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla i ortakut themelues në vlerën 100,000 Lekë (njëqind mijë) dhe përbëhet nga një 1 kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Zj. Erselana Shahinaj**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100,000 (njëqind mijë) Lekë dhe (100,000) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisllacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

**Zj. Erselana Shahinaj**, shtetase shqiptar, lindur më 05/08/1999, në Durrës, banuese në Durrës, mbajtëse e dokumentit Kartë Identiteti nr. 033306414 dhe me nr. Personal J95805009L, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administratore për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratoren Zj. Erselana Shahinaj** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES  
ERSELANA SHAHINAJ**

*Erselana Shahinaj*